




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 229/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z.Nuhi Paçarizi– Kryetar, z.Blerim Dina- Referues, z.Goran Milenković- Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “Inova” SH.P.K. & “D&T Group” SH.P.K., kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku i rekomanduar për dhënie të kontratës është OE “Comp. Ndërtimore Tregtare Mulaj SH.P.K.; N.N.SH Korben” lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi dhe sanimi i kanalizimeve të ujërave të zeza atmosferike dhe ujësjellës” me nr. prokurimit: 632-19-1366-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) Komuna Gjakovë më datën 19.06.2019 mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “Inova” SH.P.K. & “D&T Group” SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi dhe sanimi i kanalizimeve të ujërave të zeza atmosferike dhe ujësjellës” me nr. prokurimit: 632-19-1366-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) Komuna Gjakovë .

II. ANULOHET, Njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull “Ndërtimi dhe sanimi i kanalizimeve të ujërave të zeza atmosferike dhe ujësjellës” me nr. prokurimit: 632-19-1366-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) Komuna Gjakovë dhe lënda kthehet në Ri vlerësim.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V.Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues“Inova”SH.P.K. & “D&T Group”SH.P.K., aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Data e njoftimit për kontratë: 25. 03. 2019. Lloji i procedurës së aplikuar: Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar: punë Vlera e parashikuar e kontratës: 350,000.00 €.Kriteri për dhënie të kontratës(N.52)tenderi i përgjegjshëm me çamin më të ulët. Afati i fundit për dorëzimin e ofertave 15.04.2019. Data e hapjes së ofertave10.05.2019. Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave 10,05,2019. Data e njoftimit me letrën standarde për tenderues të eliminuar apo të pa suksesshëm 13.05.2019. Data e njoftimit për dhënien e kontratës: 13.05.2019. Data e kërkesës për rishqyrtim 14.05.2019. Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim 17.05.2019.

Operatori ekonomik ankues “Inova”SH.P.K. & “D&T Group” SH.P.K., si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 21.05. 2019 me nr. 229/19, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull“Ndërtimi dhe sanimi i kanalizimeve të ujërave të zeza atmosferike dhe ujësjellës” me nr. prokurimit: 632-19-1366-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) Komuna Gjakovë , duke pretenduar se janë shkelur dispozitat.

- Neni 1 par.1 dhe 3 i LPP-së-qëllimi.
- Neni 6 par. 2 i LPP-së ekonomiciteti dhe efikasiteti
- Neni 7 par.1 dhe 4 i LPP-së barazia në trajtim jo diskriminimi
- Neni41 i RRUOPP-së Ekzaminimi, Vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve
- Neni 51 par.4 i alppa-së Njoftimi i kriterëve të përzgjedhjes
- Neni 52par 4i LPP-së njoftimi i kriterëve për dhënieje të kontratës
- Neni 56 i LPP-së dispozitat e përgjithshme mbi përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe dhënien e kontratës
- Neni 59. Par. 2 dhe 4 i LPP-së- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve;

- Neni 60 par.2 i LPP-së kriteret për dhënieje të kontratës
- Neni 69- Aftësia teknike dhe profesionale;

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 29.05.2019 ka autorizuar ekspertin shqyrtues profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues profesional në raportin e dt:10.06.2019,lidhur me pretendimin ankimore te OE ankues “Inova”SH.P.K. & “D&T Group”SH.P.K., në finalizim te analizimit dhe shqyrtimit te këtij aktiviteti te prokurimit, konstaton si në vijim:

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “INOVA SH.P.K”-Gjakovë.

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin e OE ankues. se OE i rekomanduar për kontratë nuk plotëson kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare 8.1 dhe 8.2 kapaciteti ekonomik dhe financiar, janë kërkuar që OE duhet të ketë një qarkullim në vlerë minimale në shumë prej 700,000.00 euro për tri vitet e fundit, ndërsa në rastin e konzorciumit lideri duhet të ketë minimum 60% të vlerës së qarkullimit të kërkuare. Ku qarkullimi sipas deklaratave tatimore vjetore të dorëzuara me dosjen e tenderit është 106,212.55 euro

Eksperti shqyrtues ne bazë te dëshmive konstaton se OE i rekomanduar për kontratë ne oferta e tij ka te bashkangjitur deklaratën qe palët (konzorciumi) janë pajtuar qe kompania Ndërtimore Tregtare Mulajsh.p.k të jetë udhëheqës i konzorciumit, andaj duke u bazuar në kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare pika 8.1 dhe 8.2. ku lideri i grupit duhet ti ketë minimumin e qarkullimit 60% , ku 60% i 700,000.00 euro është 420,000.00 euro eksperti shqyrtues konstaton se në vërtetimin e qarkullimit te leshuar nga ProCredit Bank qarkullimi nga dt. 01.01.2016 e deri ne dt. 18.03.2019 është 433,561.30 euro. Ndërsa sa i përket deklaratave tatimore vjetore te dorëzuara nga lideri i grupit “Mulaj” sh.p.k ka vetëm për vitin 2017 dhe 2018, ku deklarata tatimore vjetore e vitit 2018 është ngarkuar e njëjta dy herë. Dhe sa i përket 60% qe duhet te plotësoj lideri i grupit të OE “Mulaj” SH.P.K qarkullimi në bazë të deklaratave tatimore vjetore arrin vlerën prej 186,971.81 qe nuk e plotëson kërkesën e AK te vendosura ne dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë. Prandaj duke u bazuar ne sqarimet me lart del se pretendimi ankimor është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.2

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues, se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar dëshmi për kapacitetin teknik profesional, sipas kërkesës së dosjes së tenderit, OE i rekomanduar për kontratë respektivisht lideri "Mulaj" SH.P.K nuk i plotëson kërkesat mbi mundësin teknike dhe/ose profesionale konkretisht referencat që janë kërkuar që referencat për punë të ngjashme me qenë me vlerë minimale me shumën prej 500,000.00 euro për tri vitet e fundit, kurse lideri i grupit të OE duhet të këtë punë të ngjashme minimumi në shumën prej 300,000.00 euro. Po ashtu theksojmë në listën e kontratave nuk është përfshira asnjë kontratë/referencë e liderit të konzorciumit " Mulaj Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE Tnova SH.P.K & D & T Group SH.P.K"-Gjakovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi dhe sanimi i kanalizimeve të ujerave të zeza, atmosferike dhe ujësjellës" me nr. të prokurimit: 632-19- 1366-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Komuna E Gjakovës SH.P.K që është në kundërshtim me kërkesat e dosjes së tenderit FTD, për çka konsiderojmë se është bërë shkelje e LPP-së.

Eksperti shqyrtues sqaron se ne ofertën e OE të rekomanduar për kontratë mungon lista e kontratave të përfunduara nga lideri i grupit të OE "Mulaj SH.P.K Sqarim: krekës në dosjen e tenderit ka qenë 500,000.00 euro qe lideri duhet të përmbush minimumin 60% e kësaj vlere qe i bie 300,000.00 euro andaj OE i rekomanduar për kontratë ka sjell referenca me vlerë prej 318.390.5 qe plotëson kërkesën e AK.

Eksperti shqyrtues konstaton se duke u bazuar ne nenin 69 të LPP-së dhe sqarimet ne nenin 39.8 i RRUOPP-së AK Komuna Gjakovë është dashur të kërkoj nga OE i rekomanduar për kontrata të sjell listën e kontratave pasi qe kontratat e përfunduara janë dëshmuar me referenca. 39.<5 Lista e kontratave te realizuara nuk është dorëzuar por janë dorëzuar dëshmitë (referenca/certifikata e pranimit/kontrata) Mund të kërkohet sqarim shtese. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është pjesërisht i qëndrueshëm.

Përgjigje në Pretendimi nr.3

OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka dorëzuar listën e personelit sipas kërkesave të dosjes së tenderit, por një listë e dorëzuar nga anetari i dytë i OE të rekomanduar për kontratë " NNSH Korben ", ku nuk janë të përfshirë fare punëtorët/stafi sipas kërkesave të dosjes se tenderit, sepse aty është precizuar se kërkohej: 10 vozitës, 12

punëtorë fizik, prandaj këtu konsiderojmë se është bërë shkelje e ligjit të LPP-së.

Duke u bazuar ne dokumentacionin ne lende eksperti shqyrtua sqaron se ne oferton e grupit të OE i rekomandua për kontratë nuk ka dëshmi të mjaftueshme për nr. të punëtorëve të angazhuar ne këtë projekt, Ne ofertën e OE Mulaj"sh.p.k është bashkangjitur lista e pagave te punëtorëve nga ATK. Tek kërkesat e AK: Janë kërkuar 10 drejtues të makinave te cilat duhen te përdoren për projektin në fjalë por nuk ka ofruare dëshmi (kontrata apo ndonjë listë te këtyre punëtorëve si drejtues te makinerisë) Janë

kërkuar 12 punëtor fizik janë ofruar dëshmi (kontrata) vetëm për 6 punëtor. Mirëpo ne ofertën e OE të rekomanduar për kontrata (udhëheqësi i grupit të OE) ka të bashkangjitur një deklaratë. Citoj: Deklarata për stafin teknik dhe profesional ku deklaroj se do të angazhoj punëtorë teknik dhe profesional ashtu siç është kërkuar në dosje të tenderit konkretisht në FTD paragrafi 9.1&9.2 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale Gjithashtu deklaroj se mund të angazhoj punëtorë shtesë sipas nevojës së paraqitur gjatë punës nëse në shpallëmi fitues për këtë projekt. Po ashtu në këtë listë të punëtorëve të dorëzuar ku në fundin e kësaj liste figurojnë edhe angazhimi i punëtorëve sipas kërkesave sezonale 5-15 punëtor, eksperti shqyrtues konstaton se AK Komuna Gjakovë është dashur të kërkojë sqarim për punëtorët fizik dhe drejtuesit e makinave. Prandaj duke u bazuar në sqarimet me lart del se ky pretendim ankimore është i bazuar

Përgjigje në Pretendimi nr.4

OE i rekomanduar për kontratë nuk i ka dorëzuar CV-të e inxhinierëve në versionin origjinal e të cilat duhet të firmosura personalisht nga inxhinieret, sipas kërkesës së dosjes së tenderit, por theksojmë se të njëjtat janë dorëzuar në versionin kopje, që është në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në dosje të tenderit, respektivisht janë shkelur dispozitat e LPP-së, Sa i përket këtij pretendimi ankimor eksperti shqyrtues sqaron se në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë CV e inxhinierëve të ofruara janë kopje të skanuara gjë që AK është dashur të kërkojë që të dorëzohen origjinali. Prandaj duke u bazuar në sqarimet me lart del se ky pretendim ankimor është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.5

7.OE i rekomanduar për kontratë nuk i ka dorëzuar pajisjet teknike/listën e pajisjeve sipas kërkesave të dosjes së tenderit dhe FTD ku është precizuar se janë kërkuar: f) 2 eskavator me peshë totale mbi 10t, ndërsa OE i rekomanduar e ka dorëzuar sipas listës së pajisjeve vetëm 1 copë (1 eskavator), g) 4 kamiona me konstruktim kipër me peshë totale mbi 10t, ndërsa OE i rekomanduar vetëm 1 copë, (1 kamion), h) 2 bagera me peshë totale maximum 10t, ndërsa OE i rekomanduar nuk e ka dërguar asnjë bager, i) 4 viber pllaka , ndërsa OE i rekomanduar e ka dërguar vetëm 1 copë (viber pllakë), j)4 vibratorë për dendësim të betonit, ndërsa OE i rekomanduar nuk e ka dorëzuar asnjë.

Në e kemi dokumentacionin ku është kërkuar nga OE i rekomanduar për kontratë sqarim shtesë në lidhje me pajisjet teknike, por OE ka dorëzuar sqarim për pajisje të cilat nuk janë përfshirë në listën e dorëzuar me dosjen e tenderit, prandaj të gjitha këto konsiderojmë se janë në kundërshtim me ligjin e prokurimit

LPP pasi çdo pajisje e cila është precizuar (përfshirë) në dokumente të dosjes së tenderit kurse ato nuk janë në listën e pajisjeve konsiderohen si dokumente shtesë dhe janë të pa vlefshme, kështu që edhe këtu konsiderojmë se është bërë shkelje e ligjit të LPP-së.

Eksperti shqyrtues duke u bazuar ne kërkesat e AK dhe ne dokumentet e dorëzuara ne oferta konstaton se :

Kërkesat ne dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë

- a) Kërkesë 2 eskavator me pesh totale mbi 1 Ot,
- b) Kërkesë 4 kamiona me konstruktim kipër me peshë totale mbi 1 Ot,
- c) Kërkesë 2 bagera me peshë totale maximum 1 Ot,
- d) Kërkesë 4 viber pllaka),
- e) Kërkesë 4 vibratorë për dendësim të betonit.

Lista e Pajisjeve nga NNSH "Korben" të bashkangjitura në ofertë

- 1. Ngjeshësi e dheut NNSH Korben (Cilindervibrues)
- 2. Rul për ngjeshjen e rrugëve NNSH Korben (Cilindervibrues)
- 3. Kamion , Man Tipi TGA 13 ton NNSH Korben
- 4. Iveco, Tipi 170 34 8 ton NNSH Korben
- 5. Kamionet, Mercedes-Benz, 2 ton NNSH Korben
- 6. Dumper, Marka KPc 1.5 ton NNSH Korben
- 7. Eskavator, Marka Volvo 23.7 ton NNSH Korben

PoashtuKompanija Tregtare “ Mulajsh.p.k ka dy kontratë qe ka marr me qerepajisjet ne vazhdim

- 1. Lopat ngarkuese (bager)
- 2. Lopat ngarkuese (bager)
- 3. Kompaktes betoni vibrator
- 4. Pllakvibruese
- 5. Eskavator me goma
- 6. Eskavator me zinxhir
- 7. Kamion kiper 17.800 ton
- 8. Kamion kiper 19.800 ton
- 9. Kamion kiper 18.800 ton

10. Kamion kiper 12.043 ton

Eksperti shqyrtues duke u bazuar ne RRUOP-në neni 39 paragrafi një thotë:

39.1 Për të lehtësuar ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, AK mund të kërkoj nga secili tenderues individualisht për sqarim të tenderit të tij/saj. KRPP ka aprovuar një formular standard B47 për sqarime për të përdorur nga AK “Kërkesë për sqarim të tenderit”. Kërkesa për sqarim dhe përgjigja duhet të bëhet përmes platformës elektronike Prandaj duke u bazuar ne dokumentet në lende eksperti shqyrtues konstaton se ne platformën e e-prokurimit nuk është i ngarkuar formulari standard i aprovuar nga KRPP-ja i cili duhet te përdoret për sqarim te dosjes se tenderit, ku OE ankues thotë se AK ka kërkuar sqarim shtesë për pajisjet qe nuk janë në listën OE të rekomanduar për kontratë. Prandaj duke u bazuar ne sqarimet me lartë del se ky pretendim ankimor është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.6

Në vendimin e AK Komuna e Gjakovës grupi jonë i OE: “ INOVA “ shpk& “ D&T Group ” sh.p.k pa të drejtë jemi eliminuar me arsyen kinse mungojnë “ Deklaratat Tatimore Vjetore të Tatimit në të Ardhurat ose Korporatave të dorëzuar në ATK AK Komuna Gjakovë na eliminon pa të drejtë për dokumente të cilat ekzistojnë dhe janë të bashkangjitura në sistem, Duke u bazuar ne dokumentacionin ne lëndë eksperti shqyrtues konstaton se OE “Inova “ SH.P.K ka te bashkangjitur Deklaratat Vjetore të Tatimit në të ardhurat për tri vitet e fundit prandaj duke u bazuar ne sqarimet me lart del se ky pretendim ankimor është i bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht si e bazuar (për arsyen që u cek me lartë), të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Operatori Ekonomik ankues përmes parashtresës me shkrim të datës:12.06.2019 ka njoftuar Panelin shqyrtues s’pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 10.06.2019 ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 19.06.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtuesi, përfaqësuesi i OE ankues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues, ku shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë

kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seance përfaqësuesi i OE-ankues OE-së ankues z. Kaqi deklaroj: Ne mbetemi ne tersi pran ankesës tone, dashta te filloj me precizimin e parashtresës Kopjen fizike ia dorëzon si prove parashtresën e protokolluar me date 19.06.2019 panelit i dorëzoj ku mbantitullin parashtrese lidhur me seancën e parashtresës për seance lënda 229/19. Njoftojmë panelin shqyrtues me anë të te parashtresës se mbesim ne tërësi sipas precizeve te shënuara ne ankese, duke theksuar se OE rekomanduar për kontrate nga Autoriteti Kontraktues KK-Gjakove Mula SHPK dhe NNSH KORBEN nuk i plotësojnë kërkesa mbi gjendjen ekonomike dhe financiare 8.1 dhe 8.2 te parapara ne DT. Si dhe kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale 9.1 dhe 9.2 sipas DT-së duke shkelur ligjin e prokurimit nenin 04. Ne si OE jemi eliminuar si mungese e jo profesionalizmit te Autoriteti Kontraktues nuk i kanë shqyrtuar te gjitha dokumentet e Grupit ekonomik dhe nuk kanë kërkuar sqarim shtese. Ndërkohë për dokumentet te cilët Autoriteti Kontraktues pretendon qe nuk i kemi lirisht mund te vërtetohet e kundërta duke pas qasje tek dokumentet e Grupit Ekonomik. Ketë e citon edhe E.SH. ne raportin e saj.

Gjatë prezantimit në seance përfaqësuesi i AK-së z. Gutaj deklaroj: Ne 5 pikat qe OE ankues ka bere në këse ne mendojmë pika e pare deklarata tatimore, ne e kemi marr për bazë qarkullimin bankar nga Pro CREDIT BANK, pika e 2 Referencat ku sipas neve ika te gjitha referencat tek pika 3 Lista e prezantuar nga ta 26 punëtorë dhe pika 5 është kërkuar me nenin 72 sipas Autoriteti Kontraktues i ka plotësuar kushtet për shpërblim me kontrate.

Gjatë prezantimit në seancë Ekspertja Shqyrtuese znj. Beka deklaroj: OE i rekomanduar për kontrate nuk ka dërguar dëshmi për 10 drejtuesit e makinave te cilat do te përdoren për projektin ne fjale po ashtu janë kërkuar 12 punëtor fizik janë ofruar dëshmi vetëm për 6 punëtor, për drejtues te automjeteve është kërkuar dëshmi me patën shofer, Qarkullimi bankar është kërkuar mbi 60% lideri i grupit qarkullimi ka qen 700.000 është kërkuar qarkullimi ketë kriter nuk e ka plotësuar sepse ne baze te qarkullimit me deklarata tatimore qe ka vërtetuar arrin vlerën 186.971.81 euro. Lideri i grupit. Mbetem prapa raportit te ekspertizës te datës 10.06.2019

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues te aprovoj ankesën tone te bazuar dhe lenden ta kthej ne rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së deklaroj: kërkojmë të refuzohet ankesa e OE ankues dhe të mbetet në fuqi vendimi i Autoriteti Kontraktues

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues/ teknik deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, lidhur me pretendimin e OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë nuk plotëson kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare 8.1 dhe 8.2 kapaciteti ekonomik dhe financiar, janë kërkuar që OE duhet të ketë një qarkullim në vlerë minimale në shumë prej 700,000.00 euro për tri vitet e fundit, ndërsa në rastin e konzorciumit lideri duhet të ketë minimum 60% të vlerës së qarkullimit të kërkuar. Ku qarkullimi sipas deklaratave tatimore vjetore të dorëzuara me dosjen e tenderit është 106,212.55 euro.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional konstaton se OE i rekomanduar për kontratë ne oferta e tij ka të bashkangjitur deklaratën që palët (konzorciumi) janë pajtuar që kompania Ndërtimore Tregtare Mulajsh.p.k të jetë udhëheqës i konzorciumit, andaj duke u bazuar në kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare pika 8.1 dhe 8.2. ku lideri i grupit duhet të ketë minimumin e qarkullimit 60% , ku 60% i 700,000.00 euro është 420,000.00 euro eksperti shqyrtues konstaton se në vërtetimin e qarkullimit të lëshuar nga ProCredit Bank qarkullimi nga dt. 01.01.2016 e deri në dt.18.03.2019 është 433,561.30 euro. Ndërsa sa i përket deklaratave tatimore vjetore të dorëzuara nga lideri i grupit "Mulaj" sh.p.k ka vetëm për vitin 2017 dhe 2018, ku deklarata tatimore vjetore e vitit 2018 është ngarkuar e njëjta dy herë. Dhe sa i përket 60% që duhet të plotësoj lideri i grupit të OE "Mulaj" SH.P.K qarkullimi në bazë të deklaratave tatimore vjetore arrin vlerën prej 186,971.81 që nuk e plotëson kërkesën e AK të vendosura në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë. Prandaj duke u bazuar në sqarimet me lart del se pretendimi ankimor është i bazuar.

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues, se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar dëshmi për kapacitetin teknik profesional, sipas kërkesës së dosjes së tenderit, OE i rekomanduar për kontratë respektivisht lideri "Mulaj"SH.P.K nuk i plotëson kërkesat mbi mundësin teknike dhe/ose profesionale konkretisht referencat që janë kërkuar që referencat për punë të ngjashme me qenë me vlerë minimale me shumën prej 500,000.00 euro për tri vitet e fundit, kurse lideri i grupit të OE duhet të ketë punë të ngjashme minimumi në shumën prej 300,000.00 euro. Po ashtu theksojmë në listën e kontratave nuk është përfshira asnjë kontratë/referencë e liderit të konzorciumit "Mulaj" Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE Tnova SH.P.K & D & T Group SH.P.K"-Gjakovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi dhe sanimi i kanalizimeve të ujerave të zeza, atmosferike dhe ujësjellës" me nr. të

prokurimit: 632-19- 1366-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Komuna E Gjakovës SH.P.K që është në kundërshtim me kërkesat e dosjes së tenderit FTD, për çka konsiderojmë se është bërë shkelje e LPP-së.

Paneli shqyrtues konform Ekspertit shqyrtues profesional konstaton se në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë mungon lista e kontratave të përfunduara nga lideri i grupit të OE "Mulaj SH.P.K Sqarim: kërkesë në dosjen e tenderit ka qenë 500,000.00 euro që lideri duhet të përmbush minimumin 60% e kësaj vlere që i bie 300,000.00 euro andaj OE i rekomanduar për kontratë ka sjell referenca me vlerë prej 318.390.5 që plotëson kërkesën e AK.

Eksperti shqyrtues konstaton se duke u bazuar në nenin 69 të LPP-së dhe sqarimet në nenin 39.8 i RRUOPP-së AK Komuna Gjakovë është dashur të kërkojë nga OE i rekomanduar për kontratë të sjell listën e kontratave pasi që kontratat e përfunduara janë dëshmuar me referenca. 39.<5 Lista e kontratave të realizuara nuk është dorëzuar por janë dorëzuar dëshmitë (referenca/certifikata e pranimit/kontrata) Mund të kërkohet sqarim shtesë. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është pjesërisht i qëndrueshëm.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka dorëzuar listën e personelit sipas kërkesave të dosjes së tenderit, por një listë e dorëzuar nga anëtarë i dytë i OE të rekomanduar për kontratë " NNSH Korben ", ku nuk janë të përfshirë fare punëtorët/stafi sipas kërkesave të dosjes së tenderit, sepse aty është precizuar se kërkohej: 10 vozitës, 12, punëtorë fizik, prandaj këtu konsiderojmë se është bërë shkelje e ligjit të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform eksperti shqyrtues profesional konstaton se në ofertën e grupit të OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dëshmi të mjaftueshme për nr. të punëtorëve të angazhuar në këtë projekt, Në ofertën e OE "Mulaj "sh.p.k është bashkangjitur lista e pagave të punëtorëve nga ATK. Tek kërkesat e AK: Janë kërkuar 10 drejtues të makinave të cilat duhen të përdoren për projektin në fjalë por nuk ka ofruar dëshmi (kontrata apo ndonjë listë të këtyre punëtorëve si drejtues të makinerisë) Janë kërkuar 12 punëtor fizik janë ofruar dëshmi (kontrata) vetëm për 6 punëtor. Mirëpo në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë (udhëheqësi i grupit të OE) ka të bashkangjitur një deklaratë. Citoj: Deklarata për stafin teknik dhe profesional ku deklaroj se do të angazhoj punëtorë teknik dhe profesional ashtu siç është kërkuar në dosje të tenderit konkretisht në FTD paragrafi 9.1&9.2 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale Gjithashtu deklaroj se mund të angazhoj punëtorë shtesë sipas nevojës së paraqitur gjatë punës nëse në shpallimi fitues për këtë projekt. Po ashtu në këtë listë të punëtorëve të dorëzuar ku në fundin e kësaj liste figurojnë edhe angazhimi i punëtorëve sipas kërkesave sezonale 5-15 punëtor,

andaj ne baze te kësaj paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional konstaton se AK Komuna Gjakovë është dashur të kërkoj sqarim për punëtoret fizik dhe drejtuesit e makinave. Prandaj duke u bazuar ne sqarimet me lart del se ky pretendim ankimore është i bazuar

Lidhur me pretendimin e ankuesit se OE i rekomanduar për kontratë nuk i ka dorëzuar CV-të e inxhinierëve në versionin origjinal e të cilat duhet të firmosura personalisht nga inxhinieret, sipas kërkesës së dosjes së tenderit, por theksojmë se të njëjtat janë dorëzuar në versionin kopje, që është ne kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në dosje të tenderit, respektivisht janë shkelur dispozitat e LPP-së. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional konstaton se ne ofertën e OE të rekomanduar për kontrata CV e inxhinierëve te ofruara janë kopje të skanuara gjë që AK është dashur te kërkoj që te dorëzohen origjinali. Prandaj duke u bazuar në sqarimet me lart del se ky pretendim ankimor është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se OE i rekomanduar për kontratë nuk i ka dorëzuar pajisjet teknike/listën e pajisjeve sipas kërkesave të dosjes së tenderit dhe FTD ku është precizuar se janë kërkuar:

f) 2 eskavator me peshe totale mbi 1Ot, ndërsa OE i rekomanduar e ka dorëzuar sipas listës së pajisjeve vetëm 1 copë (1 eskavator), g) 4 kamiona me konstruktim kipër me peshë totale mbi 1Ot, ndërsa OE i rekomanduar vetëm 1 copë, (1 kamion), h) 2 bagera me peshë totale maximum 1Ot, ndërsa OE i rekomanduar nuk e ka dërguar asnjë bager, i) 4 viber pllaka , ndërsa OE i rekomanduar e ka dërguar vetëm 1 copë (viber pllakë), j) 4 vibratorë për dendësim të betonit, ndërsa OE i rekomanduar nuk e ka dorëzuar asnjë.

Ne e kemi dokumentacionin ku është kërkuar nga OE i rekomanduar për kontratë sqarim shtesë në lidhje me pajisjet teknike, por OE ka dorëzuar sqarim për pajisje të cilat nuk janë përfshirë në listën e dorëzuar me dosjen e tenderit, prandaj të gjitha këto konsiderojmë se janë në kundërshtim me ligjin e prokurimit LPP pasi çdo pajisje e cila është precizuar (përfshirë) në dokumente të dosjes së tenderit kurse ato nuk janë në listën e pajisjeve konsiderohen si dokumente shtesë dhe janë të pa vlefshme, kështu që edhe këtu konsiderojmë se është bërë shkelje e ligjit të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform Ekspertit shqyrtues profesional konstatonte:Kërkesat ne dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë ka qenë:

- a) Kërkesë 2 eskavator me peshë totale mbi 1 Ot,
- b) Kërkesë 4 kamiona me konstruktim kipër me peshë totale mbi 1 Ot,
- c) Kërkesë 2 bagera me peshë totale maximum 1 Ot,
- d) Kërkesë 4 viber pllaka),
- e) Kërkesë 4 vibratorë për dendësim të betonit.

Lista e Pajisjeve nga NNSH "Korben" të bashkangjitura në ofertë

1. Ngjeshësi e dheut NNSH Korben (Cilindervibrues)
2. Rul për ngjeshjen e rrugëve NNSH Korben (Cilindervibrues)
3. Kamion , Man Tipi TGA 13 ton NNSH Korben
4. Iveco, Tipi 170 34 8 ton NNSH Korben
5. Kamionet, Mercedes-Benz, 2 ton NNSH Korben
6. Dumper, Marka KPc 1.5 ton NNSH Korben
7. Eskavator, Marka Volvo 23.7 ton NNSH Korben

Po ashtu Kompanija Tregtare " Mulaj" sh.p.k ka dy kontrata qe ka marr me qera pajisjet ne vazhdim

1. Lopat ngarkuese (bager)
2. Lopat ngarkuese (bager)
3. Kompaktes betoni vibrator
4. Pllakvibruese
5. Eskavator me goma
6. Eskavator me zinxhir
7. Kamion kiper 17.800 ton
8. Kamion kiper 19.800 ton
9. Kamion kiper 18.800 ton
10. Kamion kiper 12.043 ton

Paneli shqyrtues konform Ekspertit shqyrtues sqaron se duke u bazuar ne RRUOP-në neni 39 paragrafi një thotë: 39.1 Për të lehtësuar ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, AK mund të kërkoj nga secili tenderues individualisht për sqarim të tenderit të tij/saj. KRPP ka aprovuar një formular standard B47 për sqarime për të përdorur nga AK "Kërkesë për sqarim të tenderit". Kërkesa për sqarim dhe përgjigja duhet të bëhet përmes platformës elektronike Prandaj duke u bazuar ne dokumentet në lende,paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional konstaton se ne platformën e e-prokurimit nuk është i ngarkuar formulari standard i aprovuar nga KRPP-ja i cili duhet te përdoret për sqarim te dosjes se tenderit, ku OE ankues thotë se AK ka kërkuar sqarim shtesë për pajisjet qe nuk janë në listën OE të rekomanduar për kontratë. Prandaj duke u bazuar ne sqarimet me lartë del se ky pretendim ankimor është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se në vendimin e AK Komuna e Gjakovës grupi jonë i OE: " INOVA " shpk& " D&T Group " sh.p.k pa të drejtë jemi eliminuar me arsyen kinse mungojnë " Deklaratat Tatimore Vjetore të Tatimit në të Ardhurat ose Korporatave të dorëzuar në ATK AK Komuna Gjakovë na eliminon pa të drejtë për dokumente të cilat ekzistojnë dhe janë të bashkangjitura në sistem. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional konstaton se OE "Inova " SH.P.K ka te bashkangjitur

Deklaratat Vjetore të Tatimit në të ardhurat për tri vitet e fundit prandaj duke u bazuar ne sqarimet me lart del se ky pretendim ankimor është i bazuar.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK --"Kumuna e Gjakovës
- 1x1 OE: "Inova"SH.P.K. & "D&T Group"SH.P.K.
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.